



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: “**MBI SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR BANORËT E BANESAVE SOCIALE**

”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetet në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.1, neni 24, neni 54, neni 64 gërma “c”; pika 34, 45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, ligjin nr.48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.22/2018”, VKM nr.522, datë 25.07.2019 “Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë, kur banesat sociale me qira financohen nga buxheti i shtetit ose i bashkive apo nga kombinimi i tyre” dhe Vendimit të Komisionit të Strehimit,

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Bashkia Berat, duke filluar nga viti 2014, ka shlyer çdo vit kështu e kredisë së marrë nga Banka e Këshillit të Europës (CEB), ku bashkia ka detyrimin për shlyerjen e principalit, ndërsa qeveria mbulon interesat. Deri më sot është shlyer shuma prej 585,107 euro dhe mbetet për t’u shlyer deri në korrik 2026 vlera prej 2,600 euro.

Për fillimin e procedurës së subvencionimit të qirasë, bashkia ka njoftuar të gjitha familjet duke mos përjashtuar asnjë për të sjellë dokumentacionin e plotë të të ardhurave familjare mujore bazë, për llogaritjen e masës së subvencionimit të qirasë, bazuar në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”.

Situata financiare :

Nga 49 familje aplikante, 35 familje përfitojnë subvencionimin e qirasë, pasi plotësojnë kriteret ligjore dhe dokumentacionin e kërkuar. Konkretisht: 11 familje kanë të ardhura vetëm nga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

pagesa e paaftësisë; 2 familje përfitojnë ndihmë ekonomike; 2 familje janë punëkërkuës të papunë; 17 familje kanë të ardhura nga pensioni; 3 familje kanë të ardhura mujore shumë të ulëta.

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoria e Financë -Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Mjedisit.

Monitorimi dhe raportimi Drejtoria e Financë -Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Mjedisit.

Impakti social / grupet që preken:

Individet me të ardhura jot e mjaftueshme për të jetuar

A është objekt i konsultimit publik:

Jo nuk është objekt konsultimi

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale**”, i mbledhur në datën 30 /03/2026, shqyrtoi projekt vendimin “**MBI SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR BANORËT E BANESAVE SOCIALE**”

relacionin e dokumentat shoqërues propozuar nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Mjedisit.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI

- a. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- b. Miratimin e subvencionimit të qirasë në vlerën 2,079,112 lekë, për 35 familjet e strehuara në banesat sociale të bashkisë sipas tabelës bashkëlidhur.
- c. Periudha e subvencionimit të qirasë fillon me 01.02.2026 - 31.01.2027.
- d. Financimi i subvencionit të qirase do të bëhet nga buxheti i bashkisë
- e. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë -Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Mjedisit.

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

Krenar Suku- Kryetar i Komisionit

Anisa Veliu –N/Kryetar

Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit

Fatjon Elezi-Anëtar

Rovena Cuku-Anëtar

Muharem Hoxha-Anëtar

Shyqyri Dura-Anëtar

Datë 30 /03/2026